


Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. K-02/25

Datë: 20.01.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 00 .00.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Lejohet Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontroll të shumicës së aksioneve me anë të përvetësimit të 75% të kapitalit aksionar nga Çalik Renewables AG(blerës) mbi EV WIND Park Sh.p.k., (shoqëria target,) dhe EUROKOS Holding Sh.p.k., (shitës).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 13.12.2024, me Nr. Prot. 801/24 01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me marrjen e kontroll të shumicës së aksioneve me anë të përvetësimit të 75% të kapitalit aksionar nga Çalik Renewables AG(blerës) mbi EV WIND Park Sh.p.k., (shoqëria target,) dhe EUROKOS Holding Sh.p.k., (shitës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 20.12.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 20.12.2024

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose

1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm

2. Marrëveshja për Investim dhe Përvetësim të Aksioneve, e lidhur me 11.12.2024

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Çalik Renewables AG, (Investitori), është ndërmarrje e sapo themeluar për qëllime të këtij transaksioni, e cila është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, regjistruar pranë regjistrat tregtar në Kantonin e Lucernit, Zvicër me numër unik identifikues (NUI): CHE-477.476.316 dhe me adresë të regjistruar në Stegmattstrasse 1, 6033 Buchrain, Lucern, Zvicër. Çalik AG nuk ka prezencë direkte në tregun e Republikës së Kosovës, mirëpo është prezentë përmes ndërmarrjes së ndërlidhur Kosovo Çalik Limak Energy SH.A., me numër unik identifikues (NUI): 811271014, e cila si aktivitet kryesor ka mbështetjen e shoqërive të tjera aksionare që i zotëron si në vijim: Kompaninë Kosovare për Distribim me Energji Elektrike SH.A. ("KEDS") dhe Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A. ("KESCO") e që të gjitha këtë shoqëri janë pjesë e Çalik Enerji Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi ("Çalik Group").

EUROKOS Holding Sh.p.k., (shitësi), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kosovës, me numër unik identifikimi (NUI): 810520115 me adresë të regjistruar në Rr. Migjeni, Nr.23/1, Prishtinë Republika e Kosovës. Eurokos është pronare 100% e shoqërisë target.

EV WIND Park Sh.p.k. (targeti), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kosovës, me numër unik identifikimi (NUI): 810734568, me adresë të regjistruar në Rr. Agim Ramadani, Nr.125, kati 2/4 Prishtinë, Republika e Kosovës. Aktiviteti primar i shoqërisë target, është prodhimi i energjisë elektrike, aktivitete të tjera përfshijnë edhe transmetimin e energjisë elektrike, grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme dhe të rrezikshme dhe aktivitete tjera.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: është tregu i prodhimit të energjisë së ripërteritshme, përfshirë edhe transmetimin e energjisë elektrike, grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme dhe të rrezikshme dhe aktivitete tjera.

Tregu gjeografik:, tregu përkatës gjeografik përkufizohet *territori i Republikës së Kosovës*.

Analiza e konkurrencës:

Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësim për çështje të konkurrencës në tregun e Republikës së Kosovës. Blerësi synon që përmes këtij transaksioni të ngrit kapacitet e tanishme të prodhimit të energjisë së pastër apo gjelbërt me anë të prodhimit të energjisë së ripërtërishme përmes mullinjëve të erës. Nëpërmjet këtij transaksioni, Investitori, Çalik Renewables AG., synon që përmes fitimit të shumicës së pronësisë në Shoqërinë Target të kyçet në tregun ekonomik të Kosovës duke i shtuar portofolios së investimeve të tij projekte në fushën e energjisë së ripërtërishme përmes investimit dhe ndërtimit të parkut të erës Zatriqi 1 dhe Zatriqi 2. Projekti është në fazat e hershme të zhvillimit dhe mban të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme për fillimin e ndërtimit të parkut të erës nga autoritetet përkatëse në Kosovë. Lokacioni i projektit është fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, ndërtimi dhe zhvillimi i tij do të ndahet në dy pjesë brenda kësaj zone, që do të emërohen Zatriqi 1 dhe Zatriqi 2, me kapacitet të instaluar prej 35 MW në Zatriqi 1 dhe 35 MW në Zatriqi 2. Shoqëria Target zotëron leje për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese si dhe vendimet për pranimin në kornizën e rregulluar të energjisë elektrike të lëshuara të gjitha nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”).

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës dhe i cili pritet të sjellë risi dhe përparësi në shtytjen tutje të agjendës së gjelbërt, arritjes së qëllimeve dhe targeteve në industrinë e prodhimit të energjisë e kryesisht në ngritjen e kapaciteteve të burimeve të energjisë së ripërtërishme, në këtë rast energjinë e prodhuar nga mullinjtë e erës e cila në vitet e fundit ka shënuar një hov dhe rritje në Republikën e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë për vitet 2022-2031 (“**Strategjia e Energjisë**”), përmes së cilës i ka përcaktuar caqet dhe pjesëmarrjen e burimeve të energjisë së ripërtërishme në agjendën e gjelbërt. Sipas Strategjisë në fuqi, pjesëmarrja e burimeve të ripërtërishme në konsumin e sektorit të energjisë për vitin 2024 parashihet të jetë minimumi prej 13% kurse deri në vitin 2031 caku i synuar është që kjo përqindje të arrij deri në 35%. Intensifikimi i investimeve në energjinë e ripërtërishme të erës është faktor kyç dhe në masë të madhe i ndihmon arritjes së caqeve të përcaktuara nga Qeveria. Palët parashikojnë se zbatimi i përqendrimit do të ketë ndikimi të drejtpërdrejt tek konsumatorët pasi që me fillimin e prodhimit të energjisë së erës, prodhimi i energjisë elektrike i varur nga qymyri do të zvogëlohet dhe kjo do të ndikojë në çmimet e energjisë elektrike tek konsumatorë fundorë pasi që energjia elektrike e prodhuar nga era në tërësi ka shpenzime më të pakta se ajo prodhuar dhe e mbështetur nga qymyri. Transaksioni i propozuar

nuk do të ndikoj në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës.

Autoriteti ka vlerësuar se ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva